



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Http://www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues

Dr. sc. Vahid Avdiu

Nr. Prot. 1740

Datë 18.12.2015

Në mbështetje të nenit 23 të Statutit, si dhe në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës dhe nenin 3 pika 1 nënpika 1.1 të Udhëzimit Administrativ të MASHT – it 03/2015 Mbajtja e zgjedhjeve studentore dhe zgjedhja e organeve dhe këshillave në njësi akademike në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB), Këshilli Drejtues (KD) i Universitetit në mbledhjen e mbajtur me datën 14.12.2015, mori:

**VENDIM**

**Për Ndryshim dhe plotësim në  
Rregullat dhe Procedurat  
për**

**Zgjedhjet e përgjithshme në UMIB**

- I. Në nenin 4, paragrafi (3) shtohet fusnota 1, ku thuhet: Përgjithimisht për mandatin 2015-2019, respektivisht për zgjedhjet e para, në rast të dorëheqjes, ndërprerjes së kontratës, pensionimit, vdekjes, përjashtimit të mandatarit apo për ndonjë shkak tjetër, lejohet zgjedhja e anëtarit të ri të Senatit nga Këshilli i Fakultetit për mandatin e mbetur.
- II. Këshilli i Fakultetit nga pika I e këtij vendimi është i obliguar të zgjedhë anëtarin e ri të Senatit për pjesën e mbetur të mandatit 2015-2019.
- III. Këtij vendimi i bashkëngjitet Rregullat dhe procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme në UMIB, me plotësimin nga pika I e këtij Vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, si aneks i Rregullave dhe Procedurave për Zgjedhjet e Përgjithshme në UMIB.

**Arsyetim**

Këshilli Drejtues i Universitetit pasi shqyrtoi kërkesën e prof. ass. dr. Milaim Sadikut, dekan i FTU-së, për ndryshim dhe plotësim në "Rregulla dhe Procedura për zgjedhjet e përgjithshme në UMIB, për arsye se senatori nga radhët e personelit akademik të këtij fakulteti ka dhënë dorëheqje, e konsideroi të arsyeshme kërkesën, pasi zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura në UMIB kanë qenë zgjedhjet e para dhe normalisht fakultetet janë përballur edhe me situata të paparashikuara. Nga ana tjetër, periudha e mbetur e mandatit është shumë e gjatë dhe mospërfaqësimi i fakultetit në Senat do të ishte i paarsyeshëm. Bazuar në këtë që u tha më lartë, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Rektorit të UMIB-it,
3. Dekanëve të Fakulteteve,
4. Sekretarit të Përgjithshëm,
5. Drejtorit të Administratës së përgjithshme,
6. Zyrtarit ligjor.



Dr. sc. Vahid Avdiu

Kryesues i Këshillit Drejtues